



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202400951/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të fëmijëve në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**INSTITUTIT TË NXËNËSVE QË NUK DËGJOJNË**

**TIRANË**

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, realizoi inspektimin në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë Tiranë, duke evidentuar problematikat dhe adresuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimeve të organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor në interesin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**Legjislacioni për arsimin e fëmijëve me AK**

E drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila duhet të gëzohet në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga të gjithë. Kushtetuta e RSH-së në

nenet 57 dhe 59 të saj garanton të drejtën për arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim. Në këtë kontekst, fëmijë me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për t'u arsimuar sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr.69/2012), në nenin 5 përcakton se “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, **aftësia e kufizuar** ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar”. Me ndryshimet e fundit që i janë bërë ligjit nr.69/2012<sup>2</sup>, në nenin 64/1 janë dhënë këto përcaktime lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendra burimore: “1. *Qendër Burimore është institucioni i arsimit special, që ka për qëllim të mbështesë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijimësi rezultatet e të nxëniet dhe t'i përgatisë ata për gjithëpërfshirjen dhe aftësimin për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin.*”

Po kështu, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026<sup>3</sup> parashikohen ndër të tjera, si objektiva edhe:

**“A1.3.3. Fuqizimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre në qendra burimore për aftësinë e kufizuar.** Duhet zhvilluar role të reja për shkollat speciale duke i konvertuar ato në qendra burimore me një diapazon të gjerë funksionesh në dobi të mbështetjes së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në ato rajone ku mungojnë shkollat speciale, do të caktohen, fillimisht në formë pilotimi, shkollat që duhet të funksionojnë si qendra burimore për gjithë rajonin, duke marrë për bazë modele tashmë të pilotuara në disa zona të vendit.

**A1.3.4. Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.** Disa nga programet teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara janë: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, dëgjim, vështirësi në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecc (komunikim nëpërmjet figurave), etj.

**A1.3.5. Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës.**

<sup>1</sup> Komenti i Përgjithshëm nr.9 (2006), Komiteti i Gjenezës për të Drejtat e Fëmijëve, “Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, CRC/C/GC/9, 27.2.2007.

<sup>2</sup> <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/06/21/69>, L.44/2023, datë 15.06.2023

<sup>3</sup> Miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021

**A1.6.1. Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. Kjo infrastrukturë do të përshtatet për aksesin e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike, por edhe sa i takon aspekteve të higjienës, duke respektuar nevojat e veçanta të vajzave dhe djemve, si dhe aspekteve të sigurisë”.**

## **1.Objektivat e inspektimit**

Në zbatim të kompetencave ligjore monitoruese të Avokatit të Popullit dhe për të garantuar të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve (SMPDF) realizoi një inspektim të përgjithshëm në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë<sup>4</sup>.

SMPDF-ja zhvilloi inspektimin, duke patur parasysh objektivat si vijon:

- kontrolli i performancës në shkollat speciale, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin këto institucione;
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të shkollave speciale;
- vlerësimi i mjediseve dhe kushteve të shkollave speciale;
- vlerësimi social-psikologjik-shëndetësor i çdo nxënësi që edukohet në shkollat speciale;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi;

## **2. Metodologjia e inspektimit**

Metodologjia e inspektimit përmban:

- zhvillimin të bisedave paraprake me drejtuesin, punonjësit socialë të këtij institucioni të përkujdesit publik rezidencial dhe përfituesit e shërbimeve të institucionit, informacion i cili është hedhur në një formular standard për këto lloj inspektimesh.
- monitorimin dhe inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetojnë fëmijët, ku përfshihen ambientet e përbashkëta, tualetet, ushqimi, kuzhina, lavanteria, higjiena, lagështira, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme, etj.
- verifikimin të përputhshmërisë së gjendjes në vend me standardet e parashikuara në kuadrin rregullator;

---

<sup>4</sup> Inspektim i realizuar me datën 12.06.2024

- verifikimin e dokumentacioneve të fëmijëve me aftësi të kufizuar që zhvillojnë procesin e edukimit në institucionet speciale.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues i AP-së ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e shkollës speciale dhe personelin, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit dhe u lanë rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara në fund të raportit.

### **3. Organizimi dhe funksionimi i Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë**

#### *a. Profili i institutit*

Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë (INND) është institucion arsimor në nivel kombëtar që zhvillon arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (arsimi bazë), i cili zgjat 9 vjet dhe është i detyrueshëm si dhe arsimin e mesëm të lartë që zgjat 3 vjet<sup>5</sup>. INND-ja ka varësi të dyfishtë administrative nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Arsimi i mesëm i lartë është me orientim Teknologji dhe TIK (shkollë profesionale) dhe është hapur për herë të parë në vitin 2022. Ky institut ofron mësimdhënie në sistemin dygjuhësh shkrim+shqiptim dhe në gjuhën e shënjave shqip për të gjithë nxënësit që nuk dëgjojnë në RSH-së, duke ofruar edhe shërbimin e konviktit. Programi është i njëjtë me kurrikulën bazë të miratuar nga MAS-i. Me hapjen e arsimit të mesëm profesional INND-ja është pajisur me kabinetet përkatëse:

- kabineti i punës me dru;
- kabineti i rrobaqepësisë;
- kabineti i parukerisë;
- kabineti i fotografinsë.

Pra, INND-ja krijon mundësinë e marrjes së një profesioni si paruker, rrobaqepës, zdrukthtar.

Funksionimi i brendshëm dhe organizimi i këtij instituti arsimor kombëtar realizohet në përputhje me rregulloren së brendshme të vitit shkollor 2023-2024, të miratuar nga drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVA), drejtuesi i INND-së dhe Kryetari i Bordit të Prindërve<sup>6</sup>. Kjo rregullore është në

<sup>5</sup> Bazuar në pikën 1, të nenit 64, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

<sup>6</sup> Bazuar në pikën 4, të kreu XXV të të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”

përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar<sup>7</sup>. Në përmbajtje rregullorja përfshin bazën ligjore e cila përcakton fushën e veprimtarisë të këtij institucioni arsimor, procedurat e ndjekura për regjistrimin e nxënësve që nuk dëgjojnë së bashku me dokumentacionet përkatëse të aftësisë së tyre dhe kurrikula e arsimit special e këtij institucioni. Në mënyrë më të detajuar në përmbajtje të rregullores janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e stafit pedagogjik, të prindërve, të nxënësve, detyrat e stafit mbështetës (kuzhinier, ndihmëskuzhinier, sanitar, shofer, roje, kujdestar etj), duke filluar nga orari, koha e qendrimit, përgjegjësitë për zbatimin e detyrave 24/24 orë, planet mësimore, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes dhe Komisioni i Disiplinës, masat disiplinore, kurrikula, veprimtaria pas orëve mësimore, detyrat dhe funksioni i shërbimit psiko-social, biblioteka e shkollës etj.

Nga kontrolli i dokumentacioneve, në zbatim të akteve nënligjore të arsimit parauniversitar, grupi i inspektimit verifikoi dokumentet:

- planin afatmesëm 2024-2028 të INND-së miratuar nga drejtori i ZVA-së, drejtuesi i institucionit dhe Kryetari i Bordit të Prindërve<sup>8</sup>. Plani është në përputhje me planin afatmesëm të ZVA-së Tiranë mbështetur në strategjinë e arsimit parauniversitar dhe planin e veprimit për zbatimin e saj<sup>9</sup> fokusuar në rubrika si; të dhënat e INND-së, vizioni, misioni dhe objektivat strategjik, plani zhvillimor i Qendrës Burimore, plani i menaxhimit të zhvillimit të Qendrës Burimore etj<sup>10</sup>;
- planin vjetor 2023-2024 bazuar në planin afatmesëm 2021-2024 INND-së dhe në arritjet e vitit të mëparshëm, i miratuar nga drejtori i ZVA-së, drejtuesi i institucionit dhe Kryetari i Bordit të Prindërve. Rubrikat e përfshira në këtë plan janë procedurat e hartimit të planit, analiza e gjendjes, synimi, objektivat, veprimtaritë për vëzhgimin e zbatimit të planit<sup>11</sup>;
- planet dhe raportet e aktiviteteve të shërbimit psiko-social për vitin shkollor 2023-2024, miratuar nga drejtuesi i institucionit. Aktivitetet e pasqyruara në këtë plan përfshijnë zhvillimin e trajnimeve për zhvillimin e brendshëm profesional të trupës arsimore, prindërve dhe nxënësve, si dhe informimin

---

<sup>7</sup> Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” etj

<sup>8</sup>Bazuar në nenin 49 të urdhëri nr.31/2020

<sup>9</sup> vendim nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”

<sup>10</sup> Bazuar në nenin 50 të urdhëri nr.31/2020

<sup>11</sup> Bazuar në nenin 51 të urdhëri nr.31/2020

nëpërmjet bisedave e leksioneve me punonjësit e këtij institucioni arsimor për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet që ata paraqesin bazuar në nevojat e nxënësve. Gjithashtu, në këtë plan janë parashikuar dhe takimet tre mujore për vlerësimin e Planeve Individuale Edukative (PEI) të nxënësve.

- planin logopedik për klasat I-IV viti 2023-2024 të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Veprimtaritë/aktivitetet e parashikuara në këtë plan për nxënësit e klasave nga I-IV janë të lidhura me gjuhën dhe komunikimin. Gjuha dhe komunikimi i jep mundësi fëmijës për tu shprehur, për zhvillimin e kapaciteteve mendore, nocioneve bazë të folurit oral dhe nocioneve elementare të shkruarit. Këtu përfshihet leximi, shkrimi, dhe komunikimi jo verbal.

Praktika e sipërcituar bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026<sup>12</sup> ku parashikohet ndër të tjera, si objektivi edhe: “A1.3.3. ku tashmë INND-ja është në fazën e zbatimit implementimit të dhe kthimi të këtij instituti në qendër burimore për aftësinë e kufizuar.

*b). Numri i nxënësve që nuk dëgjojnë në INND*

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2023-2024 në INND nga klasa e I-XI është 75 nxënës nga të cilët 32 femra dhe 43 meshkuj. Nga numri total i nxënësve në këtë institut, 25 janë nga rrethet të akomoduar në konvikt. Konkretisht:

<b>KLASAT</b>	<b>PARALELE</b>	<b>NUMRI I NXËNËSVE</b>
I	1	5 nxënës
II	1	4 nxënës
III	1	4 nxënës
IV	1	7 nxënës
V	1	5 nxënës
VI	1	7 nxënës
VII	1	3 nxënës
VIII	1	8 nxënës
IX	1	6 nxënës
X	1	8 nxënës
XI	2	18 nxënës
<b>Gjithsej</b>	<b>12 klasa</b>	<b>75 nxënës</b>

Vlerësimi i nxënësve bazuar në diagnozat mjekësore dhe humbjes së dëgjimit është si vijon:

<sup>12</sup>Miratuar me Vendimin nr.621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave

- klasa e parë ka 4 fëmijë gjithsej nga të cilët një është me surdomutizëm dhe audiograma 90 db-100 db hypoakuzi grave; 1 me autizëm epilepsi e generalizer/idiopatike dhe audiograma 30db-40 db, 1 vështirësi në të folur dhe audiograma 30 db-45 db; 1 tetraplegjik dhe audiograma 40 db -100 db; 1 me ADHD, çrregullime të artikulimit dhe audiograma 20 db-55 db;
- klasa e dytë ka gjithsej 4 fëmijë, nga 1 të cilët është me autizëm dhe me audiograma 40 db-60 db; 1 me çrreg. të spektrit autik dhe me audiograma 20 db-30 db, 1 me surdomutizëm dhe me audiograma 90 db-100 db hypoakuzi;
- klasa e tretë ka 4 nxënës nga të cilët 1 është me epilepsi e generalizer dhe me audiograma 70 db-100 db; 1 me distrofi forma familjare, epilepsi dhe me audiograma 20 db-30 db; 1 me audiograma 20 db-30 db; 1 me epilepsi e generalizer, prapambetje mendore e moderuar dhe me audiograma 80 db-100 db;
- klasa e katërt ka 7 nxënës, nga të cilët 4 janë me surdomutizëm me audiograma 80 db-90 db; 1 me prapambetje mendore dhe me audiograma 25 db-44 db; 1 me sindromën down me audiograma 40 db-70 db; 1 me epilepsi e generalizer dhe me audiograma 80 db-90 db nuk ka reagu;
- klasa e pestë ka 5 nxënës nga të cilët 3 janë me surdomutizëm me audiograma 80 db-90 db dhe 2 me audiograma 30 db-40 db; 1 me prapambetje mendore të rëndë dhe 2 me audiograma 20 db-30 db; 1 me prapambetje mendore të moderuar dhe me audiograma 20 db-30 db;
- klasa e gjashtë ka 7 nxënës, nga të cilët 3 janë me surdomutizëm kongenital me audiograma 80 db-90 db, 60 db-90 db dhe 30 db-90 db; 2 me çrregullime të spektrit autik dhe prapambetje mendore e thellë dhe me audiograma 30 db-50 db; 1 me prapambetje mendore, distrafi miopatike dhe me audiograma 20 db-30 db; 1 me çrregullime të spektrit autik dhe prapambetje mendore dhe me audiograma 20 db-30 db;
- klasa e shtatë ka 3 nxënës, nga të cilët 1 është me surdomutizëm kongenital dhe me audiograma 80 db-100 db; 1 me sindrom dysmorf, prapambetje psikomodore e moderuar dhe me audiograma 20 db-30 db; 1 me prapambetje mendore e shkallës së lehtë, çrregullim i sjelljes dhe me audiograma 90 db-100 db;
- klasa e tetë ka 8 nxënës nga të cilët 4 nxënës me autizëm dhe me audiograma 20 db-30 db; 2 me prapambetje mendore dhe me 20 db-30 db dhe 20 db-40 db; 1 me hipoakuzi nerosensoriale e rëndë dhe me 80 db-90 db; 1 me surdomutizem dhe me audiograma 83 db-85 db;
- klasa e nëntë ka 6 nxënës nga të cilët 1 është me surdomutizem dhe me 83 db-85 db; 1 me surdomutizem kongenital dhe me audiograma 50 db-100 db; 2 me hipoakuzi nerosensoriale e rëndë dhe me audiograma 80 db-90 db; 1

me prapambetje mendore e moderuar dhe me audiograma 20 db-30 db; 1 me çrregullim prevaziv zhvillimi i pa specifikuar gjenetik dhe me audiograma 50 db-100 db;

- klasa e dhjetë ka 8 nxënës nga të cilët 2 janë me surdomutizem dhe me audiograma 83 db-85 db; 1 me hipoakuzi neroseensoriale dhe me audiograma 70 db-110 db; 2 me çrregullime të spektrit autik dhe prapambetje mendore e rëndë dhe me audiograma 30 db-110 db; 1 me encefalopati post meningoencefalit surdomutizëm, epilepsi dhe me audiograma 70 db-110 db; 1 me prapambetje mendore kardiopati dhe me audiograma 70 db-110 db; 1 me hipoakuzi billaterale e rëndë dhe prapambetje mendore dhe me audiograma 80 db-100 db;
- klasa e XI (a) ka 7 nxënës nga të cilët 4 janë me surdomutizem dhe 2 me audiograma 80 db-100 db, 1 me audiograma 70 db-100 db, 1 me audiograma 60 db-110 db; 2 me surdomutizem kongenital dhe 1 me audiograma 55 db-100 db dhe 1 me audiograma 80 db-100 db; 1 me epilepsi dhe prapambetje mendore me audiograma 80 db-100 db;
- klasa e XI (b) ka 11 nxënës nga të cilët 5 janë me surdomutizem dhe me audiograma 80 db-100 db; 2 me surdomutizem, prapambetje mendore e moderuar insuf.e.sistemit imunitar me audiograma 70 db-80 db; 2 me surdomutizem kongenial dhe prapambetje të lehtë mendore dhe me audiograma 60 db-100 db; dhe 1 me dëmtim neurosensorial dhe me 1 audiograma 20 db-40 db.

c) Stafi i Shkollës Speciale INND-së

Struktura organike e INND-së përbëhet nga 72 punonjës të miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit<sup>13</sup>, nga të cilët 1 është drejtuesi i shkollës, 2 janë nëndrejtorë, 17 mësues, 12 edukator, 1 logopedist, 2 punonjës së shërbimeve psiko-sociale (1 psikolog dhe 1 punonjës social). Ndërsa stafi mbështetës përbëhet nga 3 punonjës të sektorit të shëndetësisë (1 mjek dhe 2 infermierë) 2 punonjës të financës, 1 sekretare/arkiviste, 1 punonjës magazine, 2 punonjës kuzhine, 3 pjatolarës, 2 punonjës të lavanderisë dhe gardërobës, 1 punonjës mirëmbajtës, 1 punonjës shofer/kaldist, 4 punonjës roje i objektit, 6 punonjës sanitarë dhe 12 kujdestarë.

Stafi mbështetës/ndihmës emërohet nga Bashkia Tiranë.

---

<sup>13</sup> Urdhëri nr.419 datë 24.10.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Nxënësve që nuk dëgjojnë”



Në vlerësim të dosjeve të stafit pedagogjik edukimi dhe arsimimi i stafit pedagogjik është në përputhje me pikën 1, të nenit 84 të të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” (urdhëri nr.31/2020)<sup>14</sup>.

Nga intervista e realizuar me drejtuesin e INND-së grupi i inspektimit u informua se në zbatim të vendimin nr.148, datë 13.03.2024 “Për kriteret dhe procedurat për hapjen dhe mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit të funksionimit të tyre”, INND-ja ka aplikuar dhe ka fitur projektin për riorganizimin e institutit në qendër burimore. Bazuar në planin Strategjik Zhvillimor të Qendrës Burimore 2024-2027 INND-ja do të jetë pjesë përbërëse e Qendrës Burimore.

INND-ja mbështetet nga buxheti i shtetit por edhe nga mbështetja financiare në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare si Fondacioni për Shoqërinë e Hapur (SOROS), OSBE-ja, UNICEF-i, Save the Children. Një ndër bashkëpunorët kryesorë të këtij instituti është organizata jo-qeveritare e njerëzve që nuk dëgjojnë ANAD-i e cila zhvillon trajnime për stafin dhe prindërit e nxënësve në drejtim të avancimit të njohurive dhe përvetësimit të mëtejshëm të gjuhës së shënjave.

#### *d) Mjediset dhe kushtet e INND-së*

INND-ja shtrihet në një sipërfaqe të madhe në të cilën ndodhen 4 godina. Në hyrje ndodhet dhoma e rojeve dhe një lulishte me shumëllojshmëri pemësh dhe bimësh në të cilën ndodhet dhe një minikopësht zoologjik ku ka shpendë të ndryshëm dhe lepuj. Procesi mësimor zhvillohet në 12 klasa nga klasa e *I-rë* deri në klasën e *XI-të*. Në katin e parë të njëres prej këtyre godinave ndodhen zyra e drejtueses, shërbimit psiko-social, 1 sallë mbledhje, 1 sallë lodrash, kabineti i logopedisë, si dhe zyrat e administratës. Mjediset e jashtme janë të bollshme dhe me gjelbërim duke ofruar një mjedis relaksues. Në këto mjedise ndodhen dy njësi sportive (një kalçeto e hapur dhe një e mbyllur) si dhe një shesh lodrash. Këtë vit shkollor në mjediset e jashtme është ndërtuar dhe klasa didaktike “Shtëpia e gjelbër” (serë ku mbillen lule dhe perime të ndryshme).

---

<sup>14</sup> “...Mësuesit e shkollave të specializuara janë të diplomuar në arsim special...”

Godina e parë në të cilën zhvillohet procesi mësimor është një ndërtesë trekatëshe e pajisur me të gjitha mjetet mësimore për funksionimin normal të procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Klasat kanë hapësira dhe ndricim të mjaftueshëm në përputhje me standardet e miratuara nga MAS-i.

Godina e dytë në të cilën ndodhet konvikti është një ndërtesë tre katëshe. Në katin e parë janë 2 atelie, një mjedis që funksionon si klasë parukerie dhe berberane, një laborator fotografie, një sallë lojrash (ping-pong etj), një sallë për edukimin fizik (palestër), dy dhoma garderobë për vendosjen e mjeteve të hotelerisë (çarçafë, jorganë, batanije, jastëk etj), për nxënësit që vijnë nga rrethet. Në këtë kat ndodhen dhe mjediset ku ofrohet shërbimi mjekësor dhe dentar të pajisura me të gjitha mjetet e duhura duke përfshirë dhe laboratorin audiologjik që përcakton shkallën e humbjes së dëgjimit. Në katin e dytë janë 15 dhoma ku akomodohen djemtë e grupmoshës 9-17 vjeç, të pajisura me krevatë dollapë dhe komodina. Çdo dhomë ka dy deri në tre fëmijë, tualet dhe dushet ndodhen në fund të korridorit të pajisura me të gjitha elementet hidrosanitare të pastra, të rregullta por modele të vjetra. Në këtë kat ndodhet biblioteka e shkollës e pajisur me të gjitha elementet përkatës, mjedise çlodhëse për kalimin e orëve të lira, dhoma e televizorit dhe dhoma e kujdestareve të natës. Kati i tretë është i ndarë në dy pjesë. Në njërin anë janë vendosur vajzat e grupmoshës 9-15 vjeç dhe ambjenti përbëhet nga 8 dhoma gjumi me nga tre krevatë, një dhomë ndenjeje për të kalur kohën e lirë dhe dhoma e televizorit. Tualetet dhe dushet ndodheshin në fund të korridorit. Në anën tjetër të këtij kati, janë vendosur fëmijët e grupmoshën nga 6-8 vjeç (djem&vajza) të akomoduar në 17 dhoma të ndarë sipas gjinisë. Mjediset janë të pastra, por ndërtimet e vjetra kanë nevojë për ristrukturim. Kjo për vetë faktin se mungesa e buxheteve për një ristrukturim total ka sjellë ristrukturime të pjesshme të cilat janë të pamjaftueshme. Mjediset janë të bollshme me një kapacitet prej 400 nxënësish.

Godina e tretë është një ndërtesë një katëshe në të cilën ndodhet salla e ngrënies, kuzhina dhe lvanteria. Këto mjedise janë të pastra me të gjitha mjetet përkatëse. Në kuzhinë dhe lvanteri janë të gjitha pajisjet elektroshtëpiake.

Godina e katërt është ndërtesë dykatëshe ku në katin e parë janë kabinetet për formimin profesional dru dhe teknologji të pajisur me të gjitha mjetet mësimore, lëndën e parë dhe hapësirën e bollshme për zhvillimin e proceseve mësimore. Ndërsa, kati i dytë është vënë në dispozicion të institutit të nxënësve që nuk shikojnë.

Sigurimi i sistemit të ngrohjes në të gjitha mjediset e këtij instituti është me dizel që prej vitit 1996, i cili mirëmbahet dhe funksionon me buxhetin e shkollës. Sistemi

i freskimit është me kondicioner me energji elektrike. Shërbimet e furnizimit me ujë, energji elektrike dhe komunikimi telefonik dhe internet realizohen sipas legjisllacionit në fuqi me kontratat përkatëse.

Bazuar në intervistat e realizuara AP-ja konstatoi se drejtuesi i institucionit dhe stafi pedagogjik kishin informacion dhe njohur të kuadrit ligjor për aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset e brendshme të institucionit të edukimit. Pengesa e vetme për aplikimin e elementëve të aksesueshmërisë në mjediset e institucionit e tyre lidhet me pamjaftueshmërinë e fondeve për rristrukturimin total të gjitha godinave.

Nga monitorimi i mjedisve të këtij institucioni, AP-ja konstatoi se mjediset e shkollës janë të mira, të pastra me sipërfaqe të bollshme duke plotësuar nevojat e nxënëve që nuk dëgjojnë.

Grupi i inspektimit nisur nga intervista e realizuar me drejtuesin e INND-së, dhe faktin që ky institut është në fazën e riorganizimit për funksionimin si qendër burimore thekson se është e domosdoshme vlerësimi i mjedisve për të bërë të mundur krijimin e aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

e) Shërbimet e INND-së

Procesi i edukimit; INND-ja ofron arsimimin për nxënësit që nuk dëgjojnë. Nga vlerësimi i dosjeve të nxënësve AP-ja konstatoi se kjo kategori nxënësish mund të ketë dhe me diagnoza të ndryshme të aftësisë së kufizuar (bashkëshoqëruese). Nxënësit që frekuentojnë këtë institucion edukimi janë të pajisur me raportin mjeko-ligjor që vërteton aftësinë e kufizuar në dëgjim. Regjistrimi i fëmijëve në këtë shkollë është parashikuar në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni bazuar në shërbimin specifik në nivel kombëtar që ofrohet për këtë kategori nxënësish. Nxënësit që nuk dëgjojnë ju garantohet e drejta për arsimim në gjuhës e shenjave dhe me rekomandim të Komisionit Multidisiplinare të ZVA-ve nxënësve u sigurohen dhe tekste për mësimin e gjuhës së folur dhe komunikimit global<sup>15</sup>. Pranë INND-së është ngritur Komisioni i institucionit arsimor që udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-it dhe miraton këtë plan<sup>16</sup>.

Pra, fëmijët të cilët nuk dëgjojnë ndjekin procesin mësimor në INND, realizuar me

---

<sup>15</sup> Bazuar në nenin 85 të urdhërit 31/2020

<sup>16</sup> Bazuar në pikën 10, të nenit 80 të urdhërit 31/2020

rekomandim të Komisionit Multidisiplinar për AK pranë ZVA-ve, me miratimin e prindërve dhe PEI, duke bërë të mundur zhvillimin e mësimi me grupe mësuesish sipas lëndëve përkatëse.

Procesi i mësimdhënies për mësuesit është lehtësuar përmes instrumentit alternativ PEI, i cili hartohet nga mësuesi kujdestar i nxënësit që nuk dëgjon, me psikologjen/punonjësen sociale shkollore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijës.

Nga pikëpamja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në shkollë, mësuesit kanë një bashkëpunim të fortë me prindërit e nxënësve, duke ofruar klasa për mësimin e gjuhës së shënjave për ta. Mësuesit janë një urë lidhëse komunikimi me prindërit për progresin e fëmijës me AK. Ata mbeten faktorë shumë të rëndësishëm për ndjekjen dhe ecurinë e nxënësit me AK dhe ndërveprimet të tij me bashkëmoshatarët.

Nxënësit në INND marrin njohuri nga programet e arsimit të ciklit fillor, nga klasa I-XI, bazuar 80% në kurrikulën bazë të arsimit parashkollor me plane mësimore të hartura nga ASCAP dhe miratuar nga MAS-i duke punuar me plane edukative individuale (PEI) për çdo nxënës<sup>17</sup>.

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit<sup>18</sup>: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR), nga i cili janë përzgjedhur dhe treguesit, që ndihmojnë në vlerësimin e nevojave arsimore, për nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Ky vlerësim realizohet nga komisioni multidisiplinar për aftësinë e kufizuar, i ngritur pranë çdo njësie arsimore vendore. Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR) sjell në vëmendje një pamje më të gjerë të shëndetit, thekson komponentët funksionalë të gjendjes klinike dhe i përshkruan ata plotësisht, lehtëson planifikimin e ngjarjeve, duke ua bashkëngjitur profileve klinike dhe duke identifikuar fokusin e ndërhyrjeve, siguron informacion sipas perspektivave të ndryshme të ekipit multidisiplinar, përfshirë ato të fëmijës dhe të familjes së tij, dhe plotëson ICD-10 (*International Classification of Diseases*).

---

<sup>17</sup> Urdhëri nr.113 datë 27.02.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e planit mësimor për arsimin e mesëm të lartë, të orinetuar “Teknologji dhe TIK” për nxënësit që nuk dëgjojnë”; Urdhëri nr.643 datë 13.11.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e planit mësimor për arsimin bazë për institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë”;

<sup>18</sup>Botim i Ministrisë së Shëndetësisë Tiranë, 2012; Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit: KNF

AP-ja vlerëson punën e komisioneve multidisiplinare për aftësinë e kufizuar, të ngritur pranë çdo njësie arsimore vendore për përdorimin e kriterëve të vlerësimit bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit konkretisht për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR), por referuar nenit 64 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, këto kriterë duhet të miratohen me një udhëzues të përbashkët nga Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Ministri i Shëndetësisë.

*Ushqimi:* Bazuar në kontrollin e dokumentacioneve (menuja javore e ushqimit) dhe monitorimin e kuzhinës, AP-ja konstatoi se menuja është hartur nga ekipi multidisiplinar në përbërje të të cilit është mjeku, infermieri, nëndrejtori. Ky ekip e harton menunë duke marrë parasysh edhe propozimet e ardhura nga nxënësit nëpërmjet qeverisë së nxënësve. Gjithashtu, një risi e sjell në këtë institut është hartimi i një libri me receta të ndryshme gatimi nga nxënësit në bashkëpunim me stafin. Qëllimi i këtij libri është konsumimi i ushqimit të shëndetshëm nga nxënësit nëpërmjet recetave të përgatitura nga vetë ata. Ky libër recetash ka dhe funksionin orientues të përcaktimit të menuve. Kuota ditore është 241,66 lekë në ditë për individë bazuar në vendimin nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Përmirësimet e fundit ligjore për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike janë realizuar me Vendimin nr. 511, datë 27.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. AP-ja konstaton se masa e kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte është përcaktuar me vendim qeverie dhe duhet të indeksohet çdo vit në varësi të inflacionit për të realizuar të drejtën për ushqim të shëndetshëm, si pjesë e të drejtave njerëzore bazë të njeriut theksuar në Konferencën Ndërkombëtare të Ushqyerjes, në vitin 1992, dhe në Samitin Botëror të Ushqimit në 1996, bazuar në ligjin nr 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

Kampionët ushqimorë janë të ruajtur në mjedise të përshtatshme dhe sipas vakteve. Kuzhinierja ishte e pajisur me librezë shëndetësore.

*Transporti i fëmijëve:* Nxënësit e INND-së janë nga të gjitha vendet e RSH-së. Për nxënësit që janë nga bashkia Tiranë dhe rrethinat e saj transporti realizohet me furgon i cili është i vjetër dhe nuk plotëson standartet për aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Konkretisht për një fëmijë paratetraplegjik që zhvillonte procesin mësimor në këtë institut transporti realizohet nga vetë prindërit.

#### **4 .Rekomandime të institucioneve/organizmave ndërkombëtare**

Gjatë veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit u ka kushtuar vëmendje të veçantë garantimit efektiv të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Kjo e fundit parashtron tetë parime të përgjithshme, duke përfshirë “respektin për aftësitë në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre”. Në të bëhet u thirrje shteteve të nisin një ndryshim kulturor, duke theksuar barazinë, përfshirjen dhe mosdiskriminimin për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, duke vënë në dukje zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në kuadrin ligjor dhe rregullator në avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka sjellë në vëmendje Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 9 (2006) mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i ka rekomanduar, së fundmi, shtetit shqiptar<sup>19</sup>:

- (a) Zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar dhe rritjen e vëmendjes politike dhe investimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- (d) Të krijojë një politikë për sigurimin e pajisjeve dhe teknologjisë ndihmëse për të lehtësuar aksesin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- (e) Të sigurojë aksesin në shkolla, qendra të kujdesit shëndetësor dhe hapësirat publike, ndërtesa, shërbime dhe informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- (f) Të forcojë kapacitetin e profesionistëve për të punuar dhe mbështetur familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në mbështetje të objektivave 4.1–4.7 dhe 4.a të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komiteti i ka rekomanduar gjithashtu ndër të tjera shtetit shqiptar<sup>20</sup>:

---

<sup>19</sup>Pika 32 e Konkluzioneve përfundimtare mbi raportet 5 dhe 6 të Shqipërisë, shtator 2023

<sup>20</sup> Pika 39 e Konkluzioneve të Komitetit të KDF

(b) Sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme dhe shkollat e zakonshme për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke përshtatur kurrikulat dhe trajnimin dhe duke caktuar mësues dhe profesionistë të specializuar në klasa të integruara, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të marrin mbështetje të individualizuar dhe vëmendjen e duhur, duke u ofruar transportin dhe sigurimin e akomodimit të arsyeshëm në shkolla.....

(i) Të sigurojë që aktivitetet e lira, sportive dhe artistike dhe hapësirat e gjelbra të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme në të gjitha bashkitë, veçanërisht për vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që u përkasin grupeve minoritare dhe fëmijët që u përkasin grupeve të tjera të margjinalizuara<sup>21</sup>.

Duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, si dhe të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, kërkohet nga institucionet përgjegjëse ndërmarrja e hapave dhe e veprimeve konkrete nga institucionet përgjegjëse shtetërore edhe në kuadër të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (OQZH 4), për arsimin në vendin tonë.

Bazuar në gjetjet e mësipërme të inspektimit dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin e të drejtave të fëmijëve në interesin më të lartë të tyre dhe, konkretisht, për realizimin e një procesi arsimimi cilësor e gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e udhëzuesit të përbashkët për kriteret e vlerësimit për nxënësit me aftësi të kufizuara që do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë, bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit.
- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për indeksimin kuotës financiare të ushqimit në mensa e konvikte për nxënësit e arsimit

---

<sup>21</sup> Konkluzionet përmbyllëse pas raportit të 5-të dhe të 6-të të Shqipërisë për Konventën e të Drejtave të Fëmijës- Concluding observations on the combined fifth and sixth periodic reports of Albania, 17 October 2023, CRC/C/ALB/CO/5- <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g23/199/30/pdf/g2319930.pdf?token=mmT7I8fC2JuohnH4oq&fe=true>

parauniversitar në institucionet arsimore vit pas viti në përputhje me ndryshimin e normave të inflacionit.

- Marrjen e masave për vendosjen e një mjeti transporti që përmbush standardet e transportit dhe aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Marrjen e masave për ristrukturimin e plotë të godinave dhe përmirësimin e standardeve për krijimin e aksesueshmërisë për fëmijët me aftësi të kufizuar në të gjitha mjediset e INND-së.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**